

VENDIM
Nr.408, datë 8.6.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR UNAZA E MADHE E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza e Madhe e Tiranës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen truall 26 864m², me vlerë 229 078 496 (dyqind e njëzet e nëntë milionë e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, objekte me vlerë 293 519 021 (dyqind e nëntëdhjetë e tre milionë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëzet e një) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 522 597 517 (pesëqind e njëzet e dy milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 1 491 000 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 522 597 517 (pesëqind e njëzet e dy milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2011, për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, zëri “Për shpenzimet kapitale”.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.6.2011 dhe të përfundojë më 15.11.2011.

7. Pronarët e pasurive, të ndodhura në zonën kadastrale 8270, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Për pasuritë e ndodhura në zonën kadastrale 8280, është bërë shënimi “Rikonfirmim”, pasi kjo zonë është në procesin e futjes në sistem. Pronarët e pasurive të ndodhura në këtë zonë, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të përfundojë procesi i futjes së zonës në sistem dhe në bazë të dokumentacionit të rifreskuar që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të likuidojë pronarët e pasurive truall, të ndodhura në zonën kadastrale 8270, sipas pikës 7, të këtij vendimi.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, për pronarët e pasurive truall të ndodhura në zonën kadastrale 8280, pasi të përfundojë procesi i futjes në sistem të kësaj zone, fakt i cili do të konfirmohet zyrtarisht nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, së bashku me titujt e pronësisë, si dhe në bazë të dokumentacionit të rifreskuar, që do të dorëzojnë pronarët.

11. Pronarët e objekteve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

12. Pronarët e objekteve, për të cilët është bërë shënimi “Proces legalizimi”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i legalizimit dhe i regjistrimit në ZVRPP-në Tiranë, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

13. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të likuideojë pronarët e objekteve, sipas pikave 11 dhe 12 të këtij vendimi.

14. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuar, në favor të shtetit.

15. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në çastin kur të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuar.

16. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha